



Bazuar në Nenin 9 të Ligjit 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Nenin 80 të Ligjit Nr. 06 / L- 114 për Zyrtarët Publikë, Nenin 8 të Ligjit Nr. 03 /L-212 të Punës, Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistemetizimi e Vendeve të Punës në ASHNA, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror shpallë këtë:

KONKURS

Njësia organizative:	Zëvendësdrejtori për Shërbime Administrative Financiare
Titulli i pozitës së punës:	Shofer i Zëvendësdrejtorit për Shërbime Administrative Financiare
Nr. referues:	ASHNA/REK/01-2022
Numri i vendeve të lira:1	
Grada:	ASHNA-1B
Nëpunësi i raporton:	Zëvendësdrejtorit për Shërbime Administrative Financiare
Lloji i pozitës:	Periudhë të pacaktuar
Puna provuese:	6 (gjashtë) muaj
Orari i punës:	I plotë, 40 orë në javë

Qëllimi i vendit të punës:

1. Ofrimi i përkrahjes administrative dhe teknike për Zëvendësdrejtorin për Shërbime Administrative Financiare e ASHNA-së

Detyrat kryesore:

1. Ofron shërbime të vozitjes për Zëvendësdrejtorit për Shërbime Administrative Financiare e ASHNA-së.
2. Siguron që automjeti të jetë i pastër dhe në gjendje të mirë.
3. Përgjigjet në mënyrë të shpejtë kërkesave për mbështetje në vozitje për detyra zyrtare.
4. Mbanë të dhënat për përdorimin e automjeteve të institucionit dhe përgatitë dokumentet e nevojshëm për përdorimin e tyre.
5. Duhet të jetë në gjendje që të kryejë riparime të vogla.
6. Duhet të jetë në dispozicion për vizita zyrtare.
7. Kryen funksione rutinore të korrierit me kërkesë të Zëvendësdrejtorit për Shërbime Administrative Financiare të ASHNA-së.
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga Zëvendësdrejtorit për Shërbime Administrative Financiare.

Kërkesat e përgjithshme për pranim

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas Ligjit për Zyrtarët Publik

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

1. Aftësi komunikuese.
2. Përveç gjuhës zyrtare të Kosovës, të ketë njohuri elementare të gjuhës angleze.
3. Shkathtësi në planifikim të punës.
4. Patent shofer valid të kategorisë "B".
5. Shkathtësi kompjuterike në programet (Word, Excel, Power Point, Access).
6. Shkollim i mesëm, 2 vit përvojë pune profesionale.

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjen e Letërnyoftimit
- Certifikatën e Shtetësisë së Republikës së Kosovës
- Dëshminë nga Gjykata që kandidati nuk është denuar për ndonjë vepër penale të kryer me dashje
- Kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Formulari për aplikim mund të shkarkohet në web faqen zyrtare www.ashna-ks.org dhe www.konkursi.rks-gov.net ose në recepcionin e ndërtesës së Agjencisë për Shërbime të Navigacionit Ajror në Vrell/Lipjan (Afër Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" Limak Kosovo), dhe të dorëzohet në Zyrën e Departamentit të Burimeve Njerëzore.

Konkursi është i hapur për aplikim 15 ditë, përkatësisht nga 06/06/2022 deri 20/06/2022 në ora 16:00.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

Shpallja e rezultateve përfundimtare

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik <https://konkursi.rks-gov.net>; <https://www.ashna-ks.org>. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Mënyra e njoftimit të kandidatëve/aplikantëve

Përmes email-it, dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>; <https://www.ashna-ks.org>)

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Departamentin e Burimeve Njerëzore: |038 5958 521.